ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **POLICIA E KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **214-23-1131-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **SHËRBIME PROFESIONALE INXHINJERIKE**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**" Enggroup " SH.P.K.**
NUI	**600317540**
Adresa	**Vëllezrit Gërvalla Bll.8**
Vendi	**PRISHTINË**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**Kreshnik Shehu**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Kreshnik Shehu**
Adresa elektronike	**info@enggroup-ks.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**19.05.2023**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

SHËRBIME PROFESIONALE INXHINJERIKE

Njoftimi per kontrate eshte publkuar me 06.03.2023

Data e dorezimit te tenderit 27.03.2023

Procesverbali per hapjen e tendereve 27.03.2023

B47 Leter Standarde e kerkeses per sqarimin e tenderit 24.04.2023

Pergjigjja e Kompanise tone per sqarimet e kerkuara 26.04.2023

Leter standarde per tenderuesin e eliminuar 02.05.2023

Vendimi i AK per anulimin e aktivitetit te prokurimit 02.05.2023

Kerkesa per Rishqyrtim ne AK: 05.05.2023

Pezullimi I aktivitetit te prokurimit : 05.05.2023

Vendimi mbi refuzimin e kerkeses per Rishqyrtim ne AK : 12.05.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me date 05.05.2023 kemi bere kerkese per rishqyrtim ne AK lidhur me anulimin e ketij aktiviteti te prokurimit, dhe ankesa eshte refuzuar me 12.05.2023 me arsyetim qe eshte kerkese pa baza.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1. Qellimi

Neni 7. Barazia ne trajtim / Jo Diskriminimi

Neni 56. Dispozitat e pergjithshme per zgjedhjen e pjesemarresve dhe Dhenjen e Kontratave.

Neni 59. Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i tendereve.

Neni 60. Kriteret per dhenje te kontrates.

Neni 69. Aftesite teknike / profesionale

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te nderuar,

Me daten 24.04.2023 kemi pranuar permes platformes e-prokurimi nga AK: Policia e Kosoves, Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit, ne te cilen AK kerkon nga ne sqarime per Çmimet e paramases te cilat i cileson jo-normalisht te uleta.

Ne si OE në kete Aktivitet te prokurimit kemi dal me çmim me te liret nga OE tjere por, ne koheve te fundit kemi ofertuar per keso sherbime ne disa Aktivitete te Prokurimit, dhe te jeni te sigurt qe edhe pse kemi perdore kryesisht keso çmime, nuk jemi renditur as te paret as dytet por, kemi qen diku ka i pesti apo i gjashti apo edhe me lart, sepse krysisht ne keto lloj sherbime konkurenca eshte me e madhe dhe cmimet jane ne pergjithesi si ne kete

rast.

Duke qene se kriter per dhenje te kontrates ka qene :

Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët

Ne konsiderojme qe anulimi i aktivitetit te prokurimit eshte ne kundershtim me LPP sepse cmimet te cilat ne dhe OE tjere i kemi ofertuar jane cmime te tregut, siq edhe kemi dhene shpjegimet e tona ne sqarimet e derguara tek AK, te cilat do ti shtojme me poshte prap:

Ne kemi deshire te ofertojme me çmime me te larta, por nese vendosim çmime me te larta, nuk shperblehemi asnjehere me kontrate dhe kete po e themi nga pervoja.

Ne edhe heren e pare (qe u anulua aktiviteti i prokurimit per keto sherbime), kemi ofertuar, dhe jemi renditur nr 2 pra, jo me te liret, kryesisht çmimet e njejta i kemi patur edhe heren e kaluar, tani disa operator i kan levizur nga pak qmimet, ne i kemi ulur pak dhe kemi dale me te liret kesaj rradhe.

Ashtu siq shihet edhe dallimi me OE tjere ne kete aktivitet te prokurimit nuk eshte edhe aq i madh.

Me poshte do te japim sqarimet e kompanise tone lidhur me çmimet e ofruara nga ne.

Kompania Enggroup fillimisht deshiron te sqaroje per AK qe eshte kompani qe prej me shume se 15 vitesh aktivitet kryesor ka projektimin, dhe me pastaj mbikeqyrjen e ndertimin, kryesisht per Autoritete publike te Republikes se Kosoves.

Aktualisht ne kemi disa kontrata kornize aktive per sherbimet e projektimit ne Autoritete Kontraktuese Publike te RK siq eshte: KK Gjakove, Ministria Arsimit, KK Obiliq etj.

Cmimet edhe ne keto Aktivitete te Prokurimeve i kemi pothuajse te ngjajshme me kete Aktivitet te Prokurimit, dhe sherbimet jane kryer e jane duke u kryer pa asnje verejtje nga AK, kete e deshmojne edhe referencat qe kemi mar nga keto Autoritete. Ne si kompani jemi e specializuar ne fushen e projektimit dhe pa problem do te mund ti realizojme edhe aktivitetet e projektimit ne kontraten per te cilen po flasim.

Siq keni mundur ta shihni ne oferten tone qe kemi dorezuar tek ju, ne kemi ne zyret tona me shume se 12 inxhinjere te rregullt te lemive te ndryshme e qe kan kohe te mjaftueshme te lire qe ti kryejne edhe sherbimet qe do te kerkohen nga ju.

Te gjithe keta inxhinjer qe kan kohe te kryejne te gjitha sherbimet e ketij aktiviteti te prokurimit qe kerkohen nga ju, jane inxhinjer te punesuar me paga mujore nga ne, dhe ata inxhinjer edhe sikur te mos shperblehemi me kete kontrate pagat duhet ti marrin nga ne, keshtu qe ne thuajse nuk ngarkohemi fare financiarisht me sherbimet qe do i kryejme per ju, sepse inxhinjeret i kemi ne zyre, kohe kane, vetem shpenzime te karburanteve do te kemi ekstra, kur te dalin inxhinjeret ne teren.

Qellimi i jone eshte qe keta inxhinjer, te kene pune te vazhdueshme tek ne, ne deshirojme ti sigurojme pune te mjaftueshme, edhe nese nuk fitojme kenaqshem ne qdo kontrate qe ne lidhim, me rendesi qe te punesuarit qe ne i kemi ti mbajme te angazhuar me projekte te ndryshme.

E nese ne mbetemi pa kontrata per sherbime te tilla, ne do te detyrohemi te pushojme dikend nga puna.

Gjate viteve te kaluara (2020-22) kemi patur volum me te vogel te sherbimeve profesionale inxhinjerike, per shkak te pandemise (COVID-19), ne megjithate nuk kemi larguar nga puna asnje nga inxhinjeret e punesuar tek ne, ne jemi te interesuar te sigurojme pune per inxhinjeret tane, edhe nese cmimet jane pak me te uleta se normale, me rendesi eshte qe mos te detyrohemi ti largojme nga puna inxhinjeret tane.

Ne edhe ne vitet e me hershme kemi pasur kontrata kornize dhe me cmime te ngjajshme per sherbime te projektimit me AK si: KK Drenas dhe KK Graçanice, KK Gjakove, KK Novoberde etj kontrata te cilat jane kryer me sukses dhe per te cilat posedojm edhe referenca dhe çmimet kan qen thuajse te ngjajshme me keto.

Jeni te mireseardhur ne zyret tona, ejani, dhe do bindeni, qe e kemi seriozisht, dhe se kemi kushte dhe kapacitete per te kryer keto sherbime.

Ne kemi ofertuar me disa çmime te lira ne disa pozicione por ne disa pozicione i kemi çmimet me te mira, dhe ne baze te ketyre çmimeve ne pa problem i mbulojme shpenzimet e kesaj kontrate dhe planifikojme te kemi edhe nje fitim simbolik nga kjo kontrate.

Ne si Operator Ekonomik, deklarojme qe qendrojme mbrapa ofertes tone, dhe ju sigurojme qe sherbimet e parapara me kontrate do i kryejme sipas kushteve te kontrates.

Gjithashtu ne deklarojme qe jemi te gateshem te bejme sigurim te ekzekutimit deri ne perqindjen me te madhe qe e lejon ligji pra, perqindje me te larte sasa e zakonshmja. Perqindja e zakonshme e sigurimit te ekzekutimit eshte 10% e ne per te bindur AK qe i kryejme sherbimet dhe qendrojme mbrapa cmimeve tona, jemi te gatshem te ju sjellim sigurim te ekzekutimit 20%, 30% te vleres se kontrates.

Do te jemi te nderuar nese na jepet mundesia te punojme me Ju dhe do te bindeni qe nuk keni gabuar. **Perndryshe ne veq edhe me heret kemi kryer sherbime te projektimit per Policine e Kosoves dhe per MPB e qe edhe jemi paisur me referenca per ato sherbime.**

Dhe e theksojme prape qe deri me tani kemi pasur shume kontrata te ngjajshme e edhe tani kemi kontrata aktive te ngjajshme (me çmime te ngjajshme) dhe gjithmone sherbimet jane kryer ne menyren me te mire te mundeshme, dhe per kete kemi edhe referenca te shumta, andaj nuk dyshojme qe edhe ju do te ndaheni te kenaqur me sherbimet qe do ju ofrojme.

Ne, gjate viteve te fundit kemi ofertuar ne dhjetra tender per sherbime te ngjajshme, dhe te jeni te sigurt, qe ne te gjithe tenderet, çmimet kane qene te ngjajshme sikurse ne kete Aktivitet te Prokurimit, dhe jane lidhur kontrata me keso çmime.

Per ta deshmuar kete te bashkangjitur do ti gjeni disa kontrata qe ne si operator ekonomik i kemi kryer me sukses dhe me cmime te ngjajshme sikurse oferta jone ne kete aktivitet te prokurimit, disa kontrata te tjera te cilat gjithashtu jane duke u kryer me sukses dhe per keto kemi deshmuar me referencat e leshuara nga AK, gjithashtu bashkangjitur keni dhe disa kontrata te operatoreve tjer ekonomik te lidhur me Autoritete kontraktuese te cilat oferta permbajn cmime te ngjajshme sikur tonat (kontrata te koheve te fundit te cilat i

kemi mar nga e-prokurimi).

Ne kete aktivitet te prokurimit, ne jemi te sigurte, qe te gjithe operatoret ekonomik kane perdorur çmime te ngjajshme sikurse ne, e ndoshta ne pozicione te caktuara çmim edhe me te ulet se ne.

Nese Operatoret Ekonomik qe jane me çmime mbi ne, mund ta kryejne ndonje pozicion me 0.02 euro apo edhe me 0.01 euro, atehere pse ne nuk bene apo pse ne nuk mundemi me kry ndonje pozicion me 0,02 apo 0,01 euro.

Dhe ne jemi te sigurt qe edhe operatoret mbi ne kane keso çmime si ne apo te ngjajshme. Sipas procesverbalit te hapjes, jemi te sigurt, qe edhe ata kan çmime kryesisht si tonat.

Andaj anulimi i ketij aktiviteti te prokurimit eshte i pa drejte kur ofertat jane te ngjajshme si kete here, si heret e kaluara qe keni pasur kontrata te tilla me OE te tjere.

**Analizuam çmimet me kontraten e me hershme qe e keni patur per keso sherbime. Ne jemi me çmime me te larta se qe ishte kontraktori i me hershem i juaji. Dhe jemi goxha te sigurt qe edhe mjetet e planifikuara per kete kontrate do te shpenzohen 100% me oferten tone.

Shembull i kontrates se dates 15.06.2021 me kompanin "Studio Hapsira" qe e keni patur ju si AK per sherbime inxhinjerike deri me tani.

Ku totali i kontrates ishte 26,980.00 euro, Ne patem ofertuar atehere me çmim 42,660.00 (shih procesverbalin e hapjes / date 29.03.2021)

Foto me poshte eshte nje pozicion i shkeputur nga kontrata per sherbime inxhinjerike qe keni patur ju si AK deri me tani: - e keni te bashkangjitur ne formularin ne PDF te ngarkuar me poshte.

Pozicioni 1.1 me oferten tone, te tanishmen, do ti del çmimi:

7000 m' x (2.5 0.02=**<u>2.52</u>**) = **17,640.00 euro** / Ofertuesi i me hershem i juaji e ka pasur

çmimin per kete pozicion **8,400.00 euro** pra, dy fish me lire sesa jemi ne tash.

E njejta situate eshte edhe me pozicionet tjera.

Ne konsiderojme qe edhe nese vertet anulohet ky aktivitet, pas te gjitha procedurave ligjore qe do te ndjekim, jemi 99% te sigurt qe çmimet do te jene te ngjajshme, sepse te ngjajshme po jane edhe tek Autoritetet tjera Kontraktuese, nuk mund te beni perjashtim vetem ju. Ne si OE do te ofertojme me keso çmimi, edhe heren tjeter, nese mbeten keshtu kerkesat e kriteret.

Te gjitha kontratat per sherbime te ngjajshme qe jane lidhur kete vit (2023), keso çmime kane, perjashtim bejne nese veq jane kerkuar kriteret tjera te vleresimit.

Ju ne kete aktivitet fillimisht, heren e pare, kur e patet shpall, patet disa kritere me te veshtira per tu plotesuar, me gjase patet ankesa dhe i larguat ato kritere.

Tash nuk ka mundesi me qen kriteret minimale, kriter çmimi me i lire, dhe prap me e anulu tenderin se jane çmimet e lira.

Ju edhe po deshironi çmimin me te lire edhe po e anuloni se çmimet e lira.

Shembull:

Nese perseritet ky aktivitet edhe 2,3 apo 5 her, dhe dikur ju duhet me lidh kete kontrate, se keni nevoje per keto sherbime. Nese ne nuk ofertojme fare, apo ofertojme por nuk dalem me te liret. E ju ne fund detyroheni me shperbly me kontrate dikend qe megjithate ka çmime si ne tani.

Pyetja do duhej te ishte, si duhet te veprojme ne ateher, a duhet me ju dergu ne gjykate apo duhet me na thirre ju ne telefon e me na kerku falje qe megjithate e shperblyet nje operator qe ka çmime si tonat tani.

Çmimet per keto sherbime, me keto kritere, keto çmime jane edhe nese 15 here e perseritni aktivitetin e prokurimit.

Lusim OSHP-ne dhe ekspertin e OSHP-se qe gjate rishqyrtimit te ankeses tone te mare

parasysh provat e ofruara nga ne, konkretisht kontratat e realizuara per sherbime te njejta te cilat kane pasur cmime te njeja sikur ne kete aktivitet te prokurimit, ku per to kemi prezentuar edhe referenca positive.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, përgatitjen e kërkesave për rishqyrtim, ankesave etj.

Shkelja e supozuar ndikon tek kompania jone sepse ne aktivitetin ne fjale ne kemi dal te paret me cmimin me te lire, dhe me kete kontrate do te kishim siguruar pune per kohe te gjate per gjithe stafin tone profesional te cilin i kem me kontrata te rregullta dhe jane me shume se 12 Inxhinjere te tille.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*